Kronikë

Tiranë/ Zbuloi tradhtinë nga telefoni i të dashurës, 24-vjeçari me 2 shokë marrin peng dhe dhunojnë të riun! Përdorën një vajzë për ta futur në kurth! I morën 5 mijë euro

Ata e kanë mbajtur pa liri për disa orë në një apartament dhe e kanë dhunuar fizikisht, derisa ai u ka dhënë shumën prej 5000 eurosh. Më pas, e kanë kanosur përsëri për t'u dhënë edhe një shumë tjetër.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
10 Nëntor, 15:37 | **Përditësimi: 10 Nëntor, 17:42**

Share

TIRANË - Pesë persona morën peng për disa orë një 27-vjeçar në Tiranë dhe e dhunuan fizikisht në një apartament. Dy prej tyre u vunë në pranga, ndërsa 3 u shpallën në kërkim, Klajdi Limani dhe Suate Cenoaliaj dhe një vajzë 25 vjeçare.

Sipas policisë, 2 nga të arrestuarit, Lusjan Kimza dhe Asmireld Nimani, 24-vjeçarë si dhe 3 bashkëpunëtorët, arritën që përmes dhunës dhe presionit ta detyrojnë të riun të shkojë në banesën e tij dhe të marrë 5000 euro, të cilat u gjetën në dhomën ku ai mbahej. Edhe pasi 27-vjeçari u dha paratë, ata e kanë kërcënuar t'u japë edhe 5 mijë euro të tjera.

Burime për gazetarin Sokol Dema, bëjnë me dije se vajza në kërkim, kishte pasur një lidhje dashurie me 27-vjeçarin dhe njëkohësisht edhe me Lusjan Kimzën. Ky i fundit pa se e dashura fliste me mesazhe me 27-vjecarin dhe kërkoi t'i merrnin atij para. Ishte pikërisht 25-vjeçarja e cila u përdor si karrem për të nxjerrë në takim 27-vjeçarin.

LEXO EDHE:
Nis sot Java Kulturore Britanike! Muzikë, art, arsim dhe sport deri më 15 nëntor

Në pranga përfundoi edhe Agustin Kimza 60 vjeç, babai i njërit prej të arrestuarve, pasi iu gjet në banesë1 pistoletë me municion luftarak.

Njoftimi i policisë:

Menjëherë pas njoftimit se një shtetasi i ishte hequr liria dhe ishte dhunuar, me qëllim dhënien e një shume parash, Sektori për Hetimin e Krimeve të Rënda, në bashkëpunim me Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale, ka organizuar punën për identifikimin dhe kapjen e autorëve, si dhe për zbardhjen e rrethanave të rastit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale të shërbimeve të Policisë, në kuadër të operacionit "Kufizimi", u identifikuan 5 autorët e dyshuar të rastit, u kapën dhe u vunë në pranga 2 prej tyre, shtetasit L. K., 24 vjeç dhe A. N., 24 vjeç, si dhe u shpallën në kërkim 3 bashkëpunëtorët, shtetasit K. N., 23 vjeç, M. M., 21 vjeçe dhe S. C., 25 vjeçe.

Nga hetimet e kryera me metoda proaktive dyshohet se këta 5 shtetas kanë bashkëpunuar me njëri-tjetrin, për t'i marrë para, 27-vjeçarit. Shtetasit L. K., M. M. dhe K. N. i kanë hequr lirinë, për disa orë, 27-vjeçarit, dhe e kanë dhunuar fizikisht atë, në ambientet e një apartamenti. Pasi 27-vjeçari iu ka dhënë 5000 euro, ata e kanë kanosur sërish atë, që t'iu jepte një shumë tjetër parash.

Në vijim të operacionit, u krye kontroll në banesën e shtetasit A. K, 60 vjeç, (babai i shtetasit L. K.), ku u gjet 1 armë zjarri pistoletë me municion luftarak, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Gjatë kontrollit në dhomën ku qëndronte shtetasi L. K. u gjetën 5000 euro (dyshohet shuma e parave që i ishte marrë 27-vjeçarit).

Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurosisë, për veprime të mëtejshme.

Xh.K/S.B/Shqiptarja.com

TAG: Lusjan Kimza | Asmireld Nimani | Agustin Kimza | Tiranë | pengmarrje | Klajdi Limani | Monika Marku | Suate Cenoaliaj

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
10 Nëntor, 14:56
Pjesëmarrja e ulët në zgjedhjet e pjesshme ishte një mesazh për:

Qeverinë | Opozitën | Të dyja

Lajme të tjera

Punimet për ndërtimin e gjimnazit 'Sulejman Elezi' në Laknas, kryeministri Rama: Një hapësirë e re për 800 nxënës
10 Nëntor, 16:48

Rrugorja e Tiranës vijon aksionin, heq me karrotrec makinat e parkuara në korsitë e autobusave! Bllokon edhe 102 njësitë elektrike (VIDEO)
10 Nëntor, 13:14

Përplasi me makinë për vdekje të moshuarën në aksin Peqin - Rrogozhinë, arrestohet shoferi! U largua pas aksidentit
10 Nëntor, 12:40

Kishte punësuar 15-vjeçarin si kamarier për t'i vendosur baste sportive në lokal, arrestohet 37-vjeçari në Tiranë
10 Nëntor, 12:04

Rama krah Ballukut: Brenda mandatit, shpallim pavarësinë energjitike! Nga 2026, matësa inteligjentë të energjisë! Indeksim me 6.1% të pagave për punonjësit e OSHEE-së
10 Nëntor, 11:36

Mes shqetësimeve për mungesën e ujit, UKT arriti normë fitimi 25% për 6-mujorin e parë të vitit
10 Nëntor, 09:52

Kavajë/ Makina përplas të moshuarën në aksin Peqin–Rrogozhinë, 82-vjeçarja ndërron jetë
9 Nëntor, 19:55

'Buzi Store' përfundon në gjyq, zbardhet skema e evazionit fiskal! Rreth 3.7 milionë euro të padeklaruara
9 Nëntor, 09:20

Kushtetuesja e la në detyrë Erion Veliajn, aktorja Olta Gixhari: Lali kthehu, Tirana është qelbur
8 Nëntor, 22:02

Superliga/ Tirana prek fundin, Vora e mposht 0-2 në 'Selman Stërmasi'! Bardheblutë braktisen edhe nga tifozët
8 Nëntor, 16:00

Bileta e autobusit në Kamëz u rrit në 50 lekë, Partia e Lirisë thirrje: Anulojeni, po rëndoni xhepat e qytetarëve
8 Nëntor, 13:43

Avokati i Trump, Kasowitz: Erion Veliaj priti 9 muaj për të folur 9 minuta në Gjykatë dhe rimori detyrën e kryebashkiakut
8 Nëntor, 12:37

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje